REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

NJOFTIM

Në mbledhjen e datës 27 nëntor 2026, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe diskutimeve të zhvilluara në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, trajtoi çështjet dhe mori vendimet që vijojnë:

Bordi i ERE-s shqyrtoi informacionin mbi projekt-Kodin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, të propozuar nga OSSH sh.a., në zbatim të nenit 88 të ligjit nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike".

Projekt-Kodi sjell një sërë risish në raport me Kodin ekzistues, duke reflektuar zhvillimet e sektorit dhe modernizimin e sistemit të shpërndarjes.

Gjatë shqyrtimit u evidentua nevoja për plotësimin dhe harmonizimin e mëtejshëm të tij me kuadrin ligjor në fuqi, veçanërisht lidhur me:

- Konsultimin me të gjithë pjesëmarrësit e sektorit të energjisë elektrike;

- Rregullat dhe kërkesat teknike të matjes;

- Prokurimin e shërbimeve të fleksibilitetit;

- Integrimin e impianteve të depozitimit dhe pikave të rikarikimit të automjeteve elektrike;

- Kompensimin financiar në rastet e ridispeçerimit jashtë mekanizmave të tregut;

- Detyrimet e operatorit për informimin dhe raportim.

Në zbatim të nenit 51 të ligjit nr. 59/2026 dhe të rregullave të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 230, datë 18.08.2026, Bordi miratoi regjistrimin e dy impianteve të depozitimit të energjisë elektrike:

- "POWER ELEKTRIK SLABINJE" sh.p.k. – Impianti "BESS Slabinje 1", me fuqi nominale ngarkimi/shkarkimi 75 MW dhe kapacitet energjetik depozitimi 300 MWh, në kuadër të licencës së prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Slabinjë", Bashkia Pogradec.

- SUNNY SIDE ENERGY sh.p.k. – Impianti "Sunny Side BESS Park", me fuqi nominale ngarkimi/shkarkimi 100 MW dhe kapacitet energjetik depozitimi 400 MWh, në kuadër të licencës së prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 100 MW, në Darzezë, Bashkia Fier. Ky kapacitet depozitimi i shtohet kapacitetit prej 100,3 MWh, të reflektuar më herët në licencën e shoqërisë.

Kapaciteti energjetik i depozitimit i regjistruar në këtë mbledhje arrin në 700 MWh, me fuqi nominale totale ngarkimi/shkarkimi prej 175 MW.

Adresa: Rruga "Irfan Tomini", Njësia Administrative Nr.7, Tiranë | web: www.ere.gov.al
Tel: +355 45 620 820, +355 45 620 821; E-mail: erealb@ere.gov.al

Për vijimin e operimit të këtyre impianteve pas përfundimit të periudhës kalimtare, më 14.07.2027, shoqëritë duhet të aplikojnë në ERE për licencën përkatëse.

Bordi i ERE-s miratoi shfuqizimin e vendimit nr. 07, datë 06.02.2014, për dhënien e autorizimit për transferimin e aseteve të hidrocentraleve "Ulëz", "Shkopet", "Bistrica 1" dhe "Bistrica 2", me kapacitet total të instaluar 88,7 MW, në kuadër të marrëveshjes së financimit.

Vendimmarrja erdhi pas kërkesës së shoqërisë dhe administrimit të dokumentacionit që konfirmon shlyerjen e plotë të detyrimeve ndaj kreditorëve dhe lirimin nga garancitë përkatëse.

– Bordi i ERE-s vendosi mbi procedurën e filluar me vendimin nr. 213, datë 28.07.2026, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet dy shoqërive, nëpërmjet përcaktimit të detyrimeve konkrete për OSSH sh.a. Këto detyrime lidhen me rregullimin e konfigurimit teknik të lidhjeve 35 kV në transformatorin TR-1 të nënstacionit Prrenjas, duke adresuar problematikat e evidentuara, përfshirë ato që lidhen me mbrojtjen diferenciale, si dhe marrjen e masave të nevojshme për garantimin e sigurisë dhe funksionimit të rregullt të sistemit elektroenergjetik.

Vendimi parashikon gjithashtu detyrimin e OSSH sh.a. për raportimin periodik në ERE, mbi masat e ndërmarra, me qëllim zgjidhjen përfundimtare të problematikës dhe shmangien e përsëritjes së saj.

Vendimet e Bordit të ERE-s do të publikohen në faqen zyrtare të ERE: www.ere.gov.al.